

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" ARBES CONSTRUCTION" SH.P.K

1. Sot me datë 01/09/2023 (dymijë e njëzetëetë), unë Z.Arben Maloku, lindur ne Tirane, Albania me 13/09/1986 me adrese Tirane, ,mbajtes kartes te identitetit **I60913052T**, person madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, banues ne Tirane, nënshkruan këtë Akt Themelimi të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshte "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj.

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqerise është " ARBES CONSTRUCTION " sh.p.k.

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërise është, : TIRANE Blloku Gintash, 2 kateshet e Biznesit, Shkalla 2, Kati 2, Laprake

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërise është e pacaktuar.

Neni 4

Objekti i shoqërise

1- Eksportimi dhe importimi, tregtimi me shumice e pakice i mallrave industriale, bujqesore, blegtorale, automjete e pjese kembimi, pajisje elektroshtepiake, elektronike materiale ndertimi te çdo lloji, lendes drusore, bojrave te ndryshme plastike per mure e fasada, kimikate dhe lende te para, prodhime druri etj.Aktivitet ne fushen e transportit te brendshem e te jashtem per udhetare e per mallra ne menyre tokesore si dhe servise per te gjitha llojet e automjeteve.Mobilim dhe tregtim i pajisjeve industriale. Aktivitet ne fushen e ndertimit.Germim dheu.Prodhim materiale ndertimi, etj.Aktivitet ne fushen e ndertimit te

objekteve te permasave te ndryshme, shtepi, vila, ndertesa me shume kate ose kompleks banimi. Transportim i mbetjeve te ndryshme jo te rrezikshme

Neni 5

Kapitali Themeltar

a- Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshtruar me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë.

Neni 6

Kontributet

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

a- Z.Arben Maloku, lindur ne Tirane me 13/09/1986 dhe banues në Tiranë, mbajtes i ID nr. **I60913052T**, person madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 100 (njëqind) lekë, duke depozituar një vlerë të njëjtë pranë Credins-Bank, Shqipëri, në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Shuma e depozituar vërtetohet me një çertifikate të lëshuar nga ajo Banke.

Personi që firmosi këtë akt, pasi ka marrë dijeni për këtë çertifikate, deklaron se shuma e derdhur prej tij është në përputhje me atë që shënohet në çertifikate dhe se ajo konfirmon nënshkrimin e pjesëve të kapitalit themeltar në përputhje me shumën respektive të derdhur.

b- Sipas kontributeve të mësipërme:

Z.Arben Maloku, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8

Administratoret

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë, personi i mëposhtëm:

ARBEN MALOKU  (NENSHKRIMI)

- Arben Maloku , lindur në Tirane më 13/09/1986 dhe banues në Tiranë, mbajtës i ID nr. **I60913052T**

8.2 Administratori i shoqërise do jetë i emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare duke dhe mund të shkarkohet nga Asambleja e ortakeve.

8.3 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshme apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" dhe nenit 14 të statutit.

8.4 Administratorit i jepen të gjitha fuqitë e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe përmbushjet e parashikuara për themelimin e Shoqërise sipas legjislacionit dhe normave në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori ka të drejtën të ndihmohet nga shërbimet e të tretëve dhe të konsulentëve të cilëve mund t'u delegojë pjesërisht ose tërësisht kryerjen e veprimeve të mësipërme.

8.5 Administrator është gjithashtu i autorizuar të veproje në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendres Kombetare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrimet në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e veta edhe personave të tjerë me Prokure të Posaçme.

Neni 9

Gjuha

9.1 Ky akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

9.2 Për të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve

dhe dokumenteve si me lart, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjerisht detyrues.

ORTAKU
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ARBES CONSTRUCTION" sh.p.k
Emër Mbiemër

Arben Maloku

